



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI-TURIZËM"  
TIRANË



Tiranë, më 22/09.2023

Nr. 422 Prot

**Lënda:** Njoftim për vend të lirë pune

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Udhëzimit Nr 14, datë 27. 05. 2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore "Kreu XX1, Neni 109" Shpallja e vendit të lirë për personel mësimdhënës të kulturës profesionale me kohë të pjesshme"

Shkolla e mesme profesionale "Hoteleri-Turizëm", Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionet:

2 (dy) Mësimdhënës të formimit praktik profesional për drejtimin: "Hoteleri-Turizëm" (me kohë të pjesshme):

- 1- Specialist kuzhinë
- 2- Specialist pastičeri

1. Kriteret e përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.



Aplikanti duhet të plotësojë kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional si vijon:

- a) Të ketë diplomë nga një Shkollë e Mesme Profesionale ose të nivelit bachelor në një nga profilet , që lidhet me zhvillimin e kurrikulës profesionale të ofertuesit të AFP-së;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre ) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

### Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
  - a) letërmotivimin për pozicionin;
  - b) jetëshkrimin (CV-në);
  - c) kartën e identitetit;
  - d) diplomën;
  - e) librezën e punës;
  - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
  - g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
  - h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
  - i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
  - j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
  - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
2. Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthycra në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e institucionit, brenda datës *04 10 2023*

Adresa: Rruga e Kavojës 50  
Tel/Faks: +355 4 232 0393  
e-mail :hoteleriturizem@yahoo.com

**DREJTORE**  
**Flutura VAQARRI**

